



Datë: 26.05.2025  
Numër Protokoli: 3474/2025

A.nr.631/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyll Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.631/2025, të datës 10.04.2025, të parashtruar nga ankuesi A.K., kundër organit të punësimit/Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*pezullim nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.05.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.631/2025, e datës 10.04.2025, e parashtruar nga ankuesi A.K.

**II. Mbetet** në fuqi Vendimi me numër protokoli 2272, i datës 07.03.2025, i Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

## A r s y e t i m

Nëpunësi civil, A.K. (tutje referuar vetëm ankuesi), më datë 01.04.2025, ka dërguar ankesë tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër protokoli 2272, të datës 07.03.2025, të Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa, kjo e fundit, më datë

04.04.2025, lëndën e ka përcjell në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me ç’rast ankesa është regjistruar më datë 10.04.2025, nën shenjën A.nr.631/2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.04.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (tutje referuar vetëm MMPHI), ndërsa, kjo e fundit, më datë 17.04.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 2369/2025 të datës 10.04.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Emailin e datës 04.04.2025 nga Udhëheqësja e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MMPHI për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 16.04.2025; Akt Emërimit të datës 29.06.2011; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Asistent Administrativ; Vendimin me numër protokolli 2272, të datës 07.03.2025, të Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve të MMPHI; Emailin e datës 28.02.2025 nga Prokurori i shtetit-Prokuroria Themelore në Pejë; Emailin e datës 28.02.2025 nga A.D për V.H; Emailin e datës 13.09.2024, 10.09.2024 dhe 06.09.2024 nga L.O për V.H; Emailin e datës 13.09.2024, 06.09.2024 nga V.H për L.O; Aktvendimin PN.1.nr.860/2024 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, sepse:

Nga provat e administruara rrjedhë së ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 29.06.2011, mban pozitën e punës Asistent Administrativ në Njësine e Patentë Shoferëve në Pejë në kuadër të MMPHI.

Me tej sipas shkresave të lëndës, rezulton më Vendimin më numër protokolli 2272, të datës 07.03.2025, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e MMPHI, ka pezulluar ankuesin nga marrëdhënia e punës me 50% të ndalesës në pagë deri në përfundimin e procedurës penal apo nxjerrjen e vendimit tjetër.

Ankuesi në ankesën e parashtruar për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 2272, të datës 07.03.2025, të Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MMPHI, pretendon se ky vendim është i kundërligjshëm ngase asnjëherë nuk kam qenë dhe as nuk jam në arrest shtëpiak. Kërkon që të anulohet vendimin i kundërshtuar me ankesë.

Kolegji i Këshillit, lidhur me çështjen e pezullimit të marrëdhënies së punës së nëpunësit civil, ju referuar dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë:

- **Nenit 68 paragrafi 1**, “1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënies së punës në shërbimin civil që bëhet: 1.1. sipas detyrës zyrtare; 1.2. me kërkesë të nëpunëses/it civil”.

- **Nenit 69 paragrafi 1 dhe 2**,: “1. Nëpunësja/i civil pezullohet sipas detyrës zyrtare, në rastet si në vijim: 1.1. në rastin e procedurës disiplinore sipas paragrafit 4. të nenit 59 të këtij ligji; 1.2. kur emërohet në një nga funksionet e përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 3 të këtij ligji, për periudhën përkatëse të emërimit; 1.3. transferohet, për nevoja të institucionit, në një organizatë ndërkombëtare apo në një institucion ndërkombëtar, për periudhën përkatëse; 1.4. kur gjykata pezullon nëpunësen/in civil që është person zyrtar nga ushtrimi i detyrës, për kushtet dhe shkaqet të parapara në legjislacionin përkatës në fuqi; **1.5. ndaj nëpunëses/it civil është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të saj/tij;** 1.6. nëpunësja/i civil, mbahet në arrest në pritje të vendimit të formës së prerë; 1.7. deklarohet e/i zhdukur me vendim të formës së prerë të gjykatës, deri në shfaqjen e personit apo deklarimit

të vdekjes me vendim të formës së prerë të gjykatës; 1.8. regjistrohet apo zgjidhet, sipas ligjit, si kandidate për zgjedhjet qendrore e lokale, sipas nenit 25 të këtij ligji; 1.9. ndodhet në gjendje konflikti të vazhdueshëm interesi, sipas ligjit të veçantë, deri në transferimin e saj/tij në një pozitë tjetër, në përputhje me nenin 64 të këtij ligji; 1.10. gjatë ndjekjes së ndonjë programi arsimimi apo trajnimi më të gjatë se tridhjetë (30) ditë, për nevojat e institucionit, për periudhën që ndjek këtë program me shkëputje nga puna; 1.11. në raste të tjera, të parashikuara shprehimisht me ligj. **2. Përveç kur përcaktohet ndryshe me këtë ligj, konstatimi i shkakut të pezullimit bëhet nga: 2.1. NjMBNj e institucionit, ku nëpunësja/i ushtron detyrën”.**

- **Neni 71 paragrafi 8 dhe 9:** “8. Nëpunësja/i civil gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë, me përjashtim në rastin e përcaktuar në paragrafin 1., nën-paragrafët 1.4., 1.5., 1.6. dhe 1.7. të nenit 69 të këtij ligji, nëpunësja/i civile përfiton pesëdhjetë për qind (50 %) të pagës së plotë, duke përjashtuar çdo lloj shtesë në pagë, deri në fund të periudhës së pezullimit. 9. Në rast se procedura disiplinore apo procedura penale përfundon pa një masë disiplinore, gjegjësisht dënim penal, nëpunëses/it civil që ka qenë e pezulluar me pesëdhjetë për qind (50%) të pagës së saj/tij, i kompensohet pjesa e ndaluar e pagës bazë”.

Andaj, referuar kuadri ligjor si më lartë si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës konstatohet së Prokuroria Themelore në Pejë ndaj ankuesit ka iniciuar procedurë penale DKP.PP.nr.46/2023 datë 20.08.2024, dhe së kjo procedurë është ende në fazën e hetimeve siç konfirmohet përmes emalit të datës 28.02.2025 të zyrtares kompetente të Prokurorit të Shtetit-Prokuroria Themelore në Pejë, atëherë, mbi këto rrethana ligjore, Kolegji erdhi në përfundimin së dispozitivi i vendimit të atakuar është i drejt dhe i nxjerr në pajtim me nenin 69 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, mirëpo, arsyetimi i Vendimit me numër protokolli 2272, të datës 07.03.2025, të Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve

Njerëzore të MMPHI, përmban një konstatim të pa argumentuar se ndaj ankuesit është shqiptuar masa e sigurisë ” Arrest Shtëpiak” , sepse, bazuar në shkresat e lëndës nuk vërtetohet një fakt i tillë, rrjedhimisht, më aktvendimin që ka marrë për bazë Njësia e Personalit të Gjykatës së Apelit PN.1.nr.860/2024 të datës 05.09.2024, është ndryshuar masa e paraburgimit me masën e arrestit shtëpiak vetëm për pandehurit A.Sh, M.I dhe D.T, mirëpo, një konstatim i tillë nuk e bën të paligjshëm këtë vendim, sepse, referuar dispozitave të nenit 69 të Ligjit për Zyrtarët Publikë, pezullimi i nëpunësit civil behët në çdo rast kur ndaj të njëjtit është filluar procedurë penale për shkak të dyshimit për kryerje të veprës penale lidhur me ushtrimin e detyrës-funksionit të saj, kështu që, duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

*Lënda me numër A.nr.631/2025*

**Avdyl BEKTESHI**

*Procesmbajtës*

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet:**

- *Ankuesit A.K.;*
- *Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MMPHI; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*